



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS

---

**VENDIM**  
**nr. 439, datë 20.10.2016**

**Për**

**“Disa rekomandime mbi projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ridërguar.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |            |
|-----------|-------------|------------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar    |
| ▪ Servete | GRUDA       | Zv/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar     |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar     |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 20.10.2016, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i projekt-ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ridërguar.

**Baza ligjore:** Neni 24, germa f), neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar)

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të projekt-ligjit të ridërguar "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit",

**VËREN SE:**

1. Ministria e Financave me anë të shkresës së saj nr. 14162/1 prot, datë 14.09.2015 ka ri-sjellë për mendim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".
2. Komisioni i Konkurrencës është shprehur me anë të Vendimit nr. 379, datë 02.11.2015 "Mbi disa rekomandime mbi projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" bazuar ne vleresimin e draftit te depozituar atëkohë. Gjatë procesit te vleresimit te draftit aktual eshte marre ne konsiderate shkalla e perfshirjes se rekomandimeve te meparshme ne draftin e ridërguar.

3. Nga ky vleresim konstatohet se projektligji i përgatitur nga AMF ka parashikuar shtyrjen me një vit të datës së hyrjes në fuqi të sistemit Bonus-Malus pasi në nenin 7, (pas nenit 10, shtohet neni 10/1, pika 5) parashikon që **“Shoqëria e sigurimit zbaton sistemin bonus-malus një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji”** ndërkohë që AMF me shkresën nr. 2266/1 prot, datë 06.10.2016 drejtuar Autoritetit të Konkurrencës shprehet se: “ka përfunduar zbatimin teknik të sistemit Bonus-Malus”.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 247, datë 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, ka rekomanduar “implementimin në një kohë sa më të afërt të sistemit bonus-malus, i cili do të krijonte mundësi për një diversitet dhe aplikim të primeve të ndryshme për çdo policë sigurimi të detyrueshëm motorik, duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis kompanive që operojnë në këtë treg”.
5. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.325, datë 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, i ka rekomanduar AMF-së të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë. Por, AMF e ka marrë parasysh këtë propozim vetëm për dëmet të lidhura me dëmtimin apo shkatërrimin e pronës, kur shkalla e dëmtimit është e vogël dhe vlerësohet *deri në 100.000 lekë*.

## **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f), nenin 69, pika 1, dhe nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

## **VENDOSI:**

1. Ti rekomandojë Ministrisë së Financave që në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit":
  - a) **Në nenin 1** të projektligjit të shtohet përkufizimi mbi trajtimin e dëmit të ndodhur në Republikën e Shqipërisë **në mënyrë të drejtëpërdrejtë** nga siguruesi për të siguruarin për të gjitha kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik;
  - b) **Në nenin 7** të projektligjit **të hiqet pika 5**, e cila parashikon hyrjen në fuqi të sistemit Bonus-Malus një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit, pasi ky sistem duhet të hyjë në fuqi menjëherë me hyrjen në fuqi të Ligjit.
  - c) **Në nenin 8, pika 2** të projektligjit të parashikohet zbatim i plotë i rekomandimit të Autoritetit të Konkurrencës për sigurimin e drejtpërdrejtë për të gjitha dëmet e shkatëruara dhe jo vetëm për dëmet deri në 100.000 lekë;

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi Ministrisë së Financiare dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURENCËS

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
K R Y E T A R